



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 938/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha, dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Islam Vrenezi, kandidat për asamble të Inicativës Qytetare për Malishevë (IQM), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e pa afatshme ankesa e Islam Vrenezi, kandidat për asamble për Inicativën Qytetare të Malishevës (IQM),

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 16.11.2013, nga Islam Vrenezi, kandidat për asamble për IQM, në të cilën pretendohet se në VV 3047/01 në fshatin Marali komuna Malishevë, votat nuk janë numëruar për shkak të mos plotësimit formularit në të cilën janë bërë disa gabime. Parashtruesi i ankesës thekson se në atë vendvotim kam pasur 80 vota për asamble dhe në këtë vendvotim nuk është bërë asnjë shkelje përveç që nuk është plotësuar në rregull formulari.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa afatshme

PZAP-i, konsideron se ankesa në fjalë është e pa afatshme pasi që neni 105.1 i LZP-së parasheh që ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orësh nga ndodhja e shkeljes së supozuar. KQZ-ja me datën 14.11.2013 ka bërë publikimin e rezultateve përfundimtare ndërsa pala ankuese, ankesën ka dorëzuar në PZAP me datën 16.11.2013 çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 24 orë për dorëzimin e ankesës në PZAP, prandaj në kuptim të nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe nenit 105.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 938/2013 më datën 18.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.